



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, dhe neni 4 nga udhëzimi për renditjen e lëndëve për veprim të KSHPK-së në bazë të denoncimeve të parashtruar, KSHPK duke vepruar sipas denoncimit të parshtruar nga parashtrues i njohur në seancën e 50-të, të mbajtur më 21.07.2021, morri:

VENDIM

Kërkesa me nr. 12 - 1434/1 me datë 05.04.2021 të parashtruesit-----, REFUZOHET.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka elemente për veprim kompetent në lëndën e formuar me numër 12 - 1434 të vitit 2021 për shkak të veprimit të organeve të tjera kompetente.

Lënda me numër 12 -1434 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri te parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK -së, me arsyetim.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Lënda me numër 12 - 1434 e vitit 2021 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12 - 1434/1 të datës 05.04.2021, dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) nga parashtruesi i njohur - -----.

Në denoncimin e dorëzuar, dorëzohet dokumentacion dhe shprehet pakënaqësi me punën e disa institucioneve në RMV në lidhje me problemin e parashtruesiti cili kishte më shumë se 11 vjet në lëndën për përcaktimin e pronësisë së gjashtë personave privatë të cilët uzurpuan një rrugë publike në pronësi të RMV-së.

Bëhet fjalë për rast që parashtruesi e zbuloi në vitin 2001 dhe e denoncoi në AKP Ohër, dhe me kërkesë të tij nga Zyra e Avokatit të Shtetit PE Ohër, ishte dorëzuar parashtruesi në AKP Ohër për të përcaktuar se si personat e fituan pronën e përmendur. Lidhur me

parashtresën u miratua aktvendim në të cilën ishte konstatuar se pa bazë ligjore rruga publike ishte uzurpuar sipas gabimit të kadastrës me studimin 1970/73, dhe aktvendimi nuk u bë e plotfuqishme dhe në vitin 2009 ishte kthyer te avokati i popullit për të zgjidhur çështjen e mëparshme.

Nga ana e parashtresit për këtë rast ishin dorëzuar disa kërkesa, ankesa dhe kallëzime penale në disa institucione, përkatësisht në Avokaturën e Shtetit, Prokurorinë Themelore Publike Ohër dhe Prokurorinë e Lartë Publike në Manastir, të cilat vepruan sipas kërkesave të dorëzuara dhe brenda kompetencave të tyre miratuan vendime dhe aktvendime të përshtatshme, por ai nuk është i kënaqur me veprimet e tyre dhe përgjigjet e dorëzuara dhe dyshon se lënda qëllimisht nuk ishte proceduar si duhet.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar KSHPK arriti në përfundim se në lëndën në fjalë ishte vepruar nga organe të tjerë që janë kompetentë për të vepruar nga sfera dhe se veprimet e denoncuar nuk janë veprimtari për të cilat KSHPK ka kompetencë për të vepruar, pas së cilës vlerësoi se Komisioni Shtetëror nuk ka kompetencë për të vepruar në lëndën në fjalë, denoncimi të refuzohet për shkak të mungesës së rreziqeve nga rrezikimi i interesit publik në veprimet e personave zyrtarë në kryerjen e autorizimeve publike dhe detyrave zyrtare, lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasur parasysh të theksuaren e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

KOMISIONI SHТETЌОРОР
ПЉР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:
Arkivi
Parashtresesi
Punoi: J.C.
Miratoi: KN, anëtar i KSHPK - së

